

VENDIM
Nr. 13, datë 23.2.2016

PËR LICENCIMIN E OPERATORËVE DHE MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT UK DERI NË PËRFUNDIM TË PROCEDURAVE TË RIORGANIZIMIT TË SHOQËRIVE UK

Në zbatim të nenit 14, germa “e” dhe “i”, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator, duke pasur në konsideratë periudhën kohore që u nevojitet njëjësive të qeverisjes vendore dhe shoqërive UK për përfundimin e procedurave të riorganizimit, sipas reformës administrative territoriale,

VENDOSI:

1. Shoqëritë ujësjellës-kanalizime, të cilave u përfundon afati i licencës përpara se të përfundojë riorganizimi i tyre, sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, duhet të aplikojnë pranë ERRU-së për rinovimin e licencës ekzistuese.

2. Shoqëritë UK që përfundojnë procedurat e riorganizimit, të aplikojnë brenda tre muajve pranë ERRU-së për pajisjen me licencë të re shërbimi.

3. Shoqëritë UK do të përdorin tarifat e shërbimit UK, të miratuara nga ERRU-ja, për zonën e shërbimit sipas licencës ekzistuese të lëshuar nga ERRU-ja, deri në përfundim të procedurave të riorganizimit.

4. Për zonat e reja të cilat janë në proces të kalimit nën administrim të shoqërive UK, deri në miratimin e tarifave pranë ERRU-së, do të zbatohen tarifat që janë aplikuar në këto zona, përpara përfundimit të reformës territoriale.

5. Brenda tre muajve nga përfundimi i procedurave të riorganizimit, shoqëritë duhet të aplikojnë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave të shërbimit UK.

6. Paraqitja e aplikimit për miratimin e tarifave dhe procedura për miratimin e tyre do të kryen në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”;

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”;

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”;

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”.

7. Shoqëritë duhet të marrin masat e nevojshme për përfundimin sa më shpejt të procedurave të riorganizimit dhe pasqyrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të ndryshimeve të statusit juridik dhe zonës së shërbimit.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime.

9. Ndjekin zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat e ERRU-së, sipas përkatësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Avni Dervishi